



**Korporata Energjetike e Kosovës  
Sh.a.**

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare për vitin që ka  
përfunduar më 31 Dhjetor 2017**

## PËRMBAJTJA

	<b>Faqe</b>
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e Pozicionit Financiar	4
Pasqyra e Fitimit apo Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet	6
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	7
Shënimet për Pasqyrat Financiare	8 - 38

## RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.a.

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.a. (më tej referuar si "Kompania"), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2017, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare të Kompanisë paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar më 31 Dhjetor 2017, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit *Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me *Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë* (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinionin tonë.

### Theksimi i çështjeve:

#### Ne tërheqim vëmendje në çështjet në vijim:

- i. Zyra e Rregullatorit për Energji me 18 janar 2017 ka aprovuar Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë. Me date 26/05/2017 Korporata Energjetike e Kosovës dhe KESCO ka arrit të bëjnë Draft Marrëveshjen për Ndryshim/Plotësim të Marrëveshjes për furnizim me shumicë të energjisë elektrike (MFSH), të datës 17.10.2012 ("BSA"). Tarifa për energjinë elektrike e liferuar nga KEK është faturuar në bazë të kësaj Draft Marrëveshje e cila deri në datën e këtij Raporti nuk është nënshkruar në mes të palëve. Megjithatë menaxhmenti i kompanisë beson se Draft Marrëveshjen për Ndryshim/Plotësim do të nënshkruhet dhe nuk do të ketë efekt në ndryshime të tarifës apo kushteve tjera .
- ii. Siç është shpjeguar në Shënimin 5 të pasqyrave financiare përcjellëse, përfshirë tokën ndërtesat dhe pajisjet janë disa asete të caktuara që janë nën kontrollin e kompanisë, por për të cilat kompania nuk posedon dokumentacion përkatës të pronësisë. Kompania është në proces të marrjes së dokumentacionit të pronësisë, megjithatë kohëzgjatja dhe rezultati i procesit nuk mund të përcaktohet me ndonjë saktësi të arsyeshme, në këtë fazë.



- iii. Siç është shpalosur në Shënimin 14 të pasqyrave financiare përcjellëse aktivitetet e kompanisë rrisin nevojën e kostove të ardhshme të rëndësishme që lidhen me dëmtimin e mjedisit dekomisionimin e asetëve afatgjata. Më 31 Dhjetor 2017 bilanci i provizionimit lidhur me këto shpenzime mjedisore arrijnë 29,500 mijë Euro. Përveç kësaj kompania ka shpalosur në shënimin 26 kostot e vlerësuara të dekomisionimit të cilat nuk njihen si detyrim në pasqyrat financiare të Kompanisë pasi që nuk është përgjegjëse nga legjislacioni aktual për të kryer dekomisionimin e asetëve të saj. Shuma përfundimtare e këtyre provizionimeve është e varur mbi vlerësimet periodike të ndikimeve mjedisore dhe ardhshme të legjislacionit në lidhje me detyrimet e dekomisionimit, shumat aktuale mund të ndryshojnë materialisht nga këto vlerësime.
- iv. Siç është shpalosur në Shënimin 26 të pasqyrave financiare përcjellëse, pasqyrat financiare të Kompanisë për vitet e përfunduara nga 31 Dhjetor 2011 deri në vitin 2017 janë subjekt i inspektimit nga organet tatimore lokale. Menaxhmenti i Kompanisë ka përdorur vlerësimin dhe gjykimin e tij më të mirë për të qenë në përputhje me ligjet tatimore, duke përfshirë edhe përdorimin e rezultateve të inspektimeve të mëparshme tatimore. Megjithatë deri në kompletimin e inspektimeve të organeve tatimore shpenzimet detyrimet dhe parapagimet e tatimeve nuk mund të konsiderohen të finalizuar. Në këtë fazë nuk mund të përcaktohet me një siguri të arsyeshme një provizionim nëse do të rrjedhin tatime dhe gjopa shtesë .

Opinionin ynë nuk është i modifikuar në lidhje me çështjet e detajuara në paragrafët i dhe v më lartë .

#### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së kompanisë për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Kompaninë apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë



## Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Kompanisë.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.


*BDO Kosova L.L.C.*


BDO Kosova L.L.C.  
Rr. Pashko Vasa, Nr. 46  
10 000 Prishtinë, Kosovë  
27 Mars 2018

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Pasqyra e Pozicionit Financiar**  
**Më 31 Dhjetor 2017**

	Shënim	Më 31 Dhjetor 2017 (në 000 Euro)	Më 31 Dhjetor 2016 (në 000 Euro)
<b>ASETET</b>			
<b>Asetet jo-qarkulluese</b>			
Prona, impiantet dhe pajisjet	5	284,146	305,721
Asetet e paprekshme	6	17	44
<b>Total asetet jo-qarkulluese</b>		<b>284,163</b>	<b>305,765</b>
<b>Asetet qarkulluese</b>			
Stoqet	7	20,497	22,950
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera,neto	8	22,854	22,212
Tatimi në të ardhura i arkëtueshëm		1,918	3,349
Paraja në dorë dhe në bankë	9	89,609	63,305
<b>Total asetet qarkulluese</b>		<b>134,878</b>	<b>111,816</b>
		<b>419,041</b>	<b>417,581</b>
<b>GJITHSEJ ASETET</b>			
<b>EKUITETI DHE DETYRIMET</b>			
<b>Ekuiteti i aksionarëve</b>			
Kapitali aksionar	10	25	25
Rezervat	11	565,797	565,772
(Humbjet) e akumuluar		(442,954)	(463,912)
<b>Gjithsej ekuiteti i aksionarëve</b>		<b>122,868</b>	<b>101,885</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet jo-qarkulluese</b>			
Huamarrjet - pjesa afatgjatë	12	171,804	182,680
Grantet e shtyera	13	33,120	39,037
Provizionet	14	47,684	52,333
Detyrimet e shtyera tatimore	25	11,749	11,773
<b>Total detyrimet jo-qarkulluese</b>		<b>264,357</b>	<b>285,823</b>
<b>Detyrimet qarkulluese</b>			
Huazimet - pjesa afatshkurtër	12	11,309	7,550
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	15	15,097	14,780
Shpenzimet akruale	16	5,410	7,543
<b>Total detyrimet qarkulluese</b>		<b>31,816</b>	<b>29,873</b>
		<b>296,173</b>	<b>315,697</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>419,041</b>	<b>417,581</b>
<b>GJITHSEJ KAPITALI DHE DEYRIMET</b>			

Këto pasqyra financiare janë aprovuar për publikim nga Menaxhmenti dhe nënshkruar në emër të tyre më 21 Mars 2018.

  
 Ztr. Arben Gjakaj  
 Drejtor Menaxhues

  
 Ztr. Salih Bytyqi  
 Drejtor Financiar

Shënimet përcjellëse nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Pasqyra e Fitimit apo Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse**  
**Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017**

	Shënim	Për fund vitin 31 Dhjetor 2017 (në 000 Euro)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (në 000 Euro)
Të hyrat nga shitjet e rrymës	17	160,464	156,609
Të hyrat nga grantet	18	5,917	6,462
Të hyrat tjera	19	5,836	6,282
		<u>172,217</u>	<u>169,353</u>
<b>Shpenzimet operative</b>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5,6	(35,125)	(35,195)
Shpenzimet e personelit	20	(48,242)	(48,983)
Energjia elektrike dhe komunalitë	21	(19,797)	(12,553)
Shpenzimet e mirëmbajtjes		(3,381)	(3,158)
Materialet dhe furnizimet		(6,940)	(4,913)
Shpenzimet e linjtit	16	(22,734)	(26,670)
Lirimi i provizioneve/Provizionet për shlyerjen e inventarit	7	(643)	431
Humbjet nga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve	8	-	(310)
Ndryshimet në provizione	14	1,634	902
Shpenzimet e tjera operative	22	(10,281)	(17,422)
		<u>(145,509)</u>	<u>(147,871)</u>
<b>Fitimi nga operacionet</b>		<b>26,708</b>	<b>21,482</b>
Shpenzimet/ (të hyrat) financiare,neto	23	(2,882)	(7,623)
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>23,826</b>	<b>13,859</b>
Tatimi në fitim	24	(2,868)	(2,861)
<b>Fitim neto për vitin</b>		<b>20,958</b>	<b>10,998</b>
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
Efeki i tatimit të shtyer në rivlerësimin e pronës, impianteve dhe paisjeve	25	25	37
<b>Gjithsejtë ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>20,983</b>	<b>11,035</b>

Shënimet përcjellëse nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Pasqyra e Ndyshimeve në Ekuitet**  
**Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali aksionar	Rezervat	(Humbjet) e akumuluar	Gjithsej
	(në 000 Euro)			
Gjendja më 1 Janar 2016	25	565,735	(474,910)	90,850
Fitimi i vitit	-	-	10,998	10,998
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	37	-	37
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>-</b>	<b>37</b>	<b>10,998</b>	<b>11,035</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>25</b>	<b>565,772</b>	<b>(463,912)</b>	<b>101,885</b>
Gjendja më 1 Janar 2016	25	565,772	(463,912)	101,885
Fitimi i vitit	-	-	20,958	20,958
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	25	-	25
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>-</b>	<b>25</b>	<b>20,958</b>	<b>20,983</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>25</b>	<b>565,797</b>	<b>(442,954)</b>	<b>122,868</b>

Shënimet përcjellëse nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**  
**Pasqyra e Rrjedhës së Parasë**  
**Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017**

		Për fund vitin 31 Dhjetor 2017	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016
	Note	(në 000 Euro)	(në 000 Euro)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Fitimet para tatimit		23,826	13,859
Rregullimet e zërave jo-monetar:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5,6	35,125	35,195
Amortizimi i granteve	18	(5,917)	(6,462)
Të ardhurat nga interesi	23	0	(4)
Shpenzimet e interesit	23	2,882	7,627
Provizion për borxhet e dyshimta	8		310
Provizion për kostot e mjedisit dhe pensione	14	(4,649)	(902)
Provizioni për shlyerjet/kthimet e stoqeve	7	643	(431)
Humbja nga pajisjet e dëmtuara	5,22	-	-
Shlyerja e pronës, impianteve dhe paisjeve	5,22	104	502
<b>Fitimi para ndryshimeve në asetet dhe detyrimet operative</b>		<b>52,014</b>	<b>49,694</b>
Zvogëlim/(Rritje) në stoqe		1,810	(3,569)
Zvogëlim/(Rritje) në të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		1,159	(739)
Rritje/(Zvogëlim) në të pagueshmet tregtare dhe të tjera dhe shpenzime akruale		(1,816)	(352)
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>53,167</b>	<b>45,034</b>
Interesi i pranuar		-	4
Interesi i paguar		(3,283)	(7,301)
Tatimi në të ardhura i paguar		(2,360)	(2,848)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative, neto</b>		<b>47,524</b>	<b>34,889</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive</b>			
Blerjet e pronës impianteve dhe pajisjeve	5	(13,670)	(10,149)
<b>Paraja e përdorur në aktivitetet investive</b>		<b>(13,670)</b>	<b>(10,149)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare</b>			
Kredite e paguara gjatë vitit		(7,550)	(2,556)
<b>Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financiare</b>		<b>(7,550)</b>	<b>(2,556)</b>
<b>Rritja/(zvogëlimi) neto në ekuivalentet e parasë</b>		<b>26,304</b>	<b>22,184</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		63,305	41,121
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	<b>9</b>	<b>89,609</b>	<b>63,305</b>

Shënimet përcjellëse nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

---

### 1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Korporata Energjetike e Kosovës sh.a ("Kompania" apo "KEK") është Kompani Aksionare e inkorporuar në Kosovë dhe e regjistruar në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës me nr. të regjistrimit 70325399 të datës 27 dhjetor 2005. Kompania është transformuar në Shoqëri Aksionare (sh.a) sipas Misioni i Kombeve të Bashkuare në Kosovë ("UNMIK") rregullorja me nr.2001/6. Adresa e zyrës qendrore e regjistruar është: Rr. Nëna Terezë nr. 36, 10 000 Prishtinë, Kosovë.

Kapitali fillestar i kompanisë të regjistruar arrin në 25 mijë euro.Librat e Kompanisë janë hapur nga 1 janari 2005, bazuar në Raportin e kujdesit të duhur financiar, më 1 janar 2005 nga një vlerësues i pavarur.

Kompania është 100% degë e Korporatës Energjetike të Kosovës Holding Sh.a., ku në përputhje me Ligjin Nr 03 / L-087 të datës 13 qershor 2008 mbi "Ligjin për Ndërmarrjet Publike", Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. "KEK SH.A.", është në pronësi të Republikës së Kosovës.

Aktivitetet kryesore të Kompanisë janë prodhimi energjisë, aktivitetet e mihjeve dhe nxjerrja e linjtit të përdorura nga termocentralet.

Struktura aktuale operative e Kompanisë përbëhet nga zyrat qendrore dhe ndarjet e mëposhtme:

- Divizioni i prodhimit të Linjtit;
- Divizioni i prodhimit të energjisë elektrike - Kosova B;
- Divizioni i prodhimit të energjisë elektrike - Kosova A;

Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës - Divizioni i Gjenerimit (KEK sh.a.) - TC Kosova A për energji elektrike shtyhet për periudhën nga 4 tetor 2016 deri më 4 tetor 2017 (numri i licencës ZRRE / Li\_05 / 13\_A,) nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës - Divizioni i Gjenerimit (KEK sh.a.) - TC Kosova B për prodhimin e energjisë elektrike jepet për periudhën nga 4 tetor 2006 deri më 4 tetor 2026 (numri i licencës ZRRE\_Li\_05 / 13\_B) nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE).

Ndërsa më 23 dhjetor 2014 licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK sh.a.), Divizioni i Gjenerimit "TC Kosova B", me numër të licencës ZRRE / Libp\_05 / 14\_B, është modifikuar në "Licenca e Bashkëprodhimit të Energjisë Elektrike dhe Termike " nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me të gjitha dispozitat e tjera të licencës së mëparshëm kanë mbetur në fuqi.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.), gjatë dhjetorit 2014 ka filluar projektin e bashkëprodhimit, të energjisë termike ku energjia termike i'u është shitur Termokos sh.a.në mënyrë që të sigurohet furnizimi me ngrohje në Prishtinë.

Qeveria e Kosovës ka filluar procesin e privatizimit të KEK-ut për Rrjetin e Shpërndarjes dhe Divizionet e Furnizimit.Prandaj, më 8 maj, 2013 rrjeti i furnizimit dhe shpërndarjes nuk janë duke operuar nga KEK-u.

## **2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të lëshuara nga Bordi për Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK").

### **2.2 Bazat e përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç për rivlerësimin e pasurive të caktuara të aseteve financiare dhe detyrimeve financiare, siç shpjegohet në politikat e kontabilitetit më poshtë. Kostoja historike është bazuar në përgjithësi duke pasur parasysh këmbimin për një aset.

### **2.3 Parimi i vijmësisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi një bazë vijmësie.

Në bazë të këtij supozimi, menaxhmeti ka marrë në konsideratë faktin se Kompania ka humbje të akumuluar të rëndësishme më 31 dhjetor 2017 në shumë 442 milion Euro (2016: 463 milion Euro). Mirëpo, Kompania ka gjeneruar fitim në vitet e fundit dhe pas ndarjes së divizionit të Shpërndarjes dhe Furnizimit, nuk mbështetet më në grantet e Qeverisë për të operuar.

### **2.4 Valuta në përdorim**

Valuta në përdorim dhe ajo e cila përdoret për qëllime të raportimit të Kompanisë është Euro (EUR), ku në përputhje me udhëzimet e Unionit Monetar Evropian dhe instruksionet e leshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, EUR është adoptuar si valuta e vetme e ligjshme në territorin e Kosovës nga 1 janar 2002.

### **2.5 Transaksionet në valutën e huaj**

Transaksionet në valuta tjera përveç Euros regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga shlyerja e transaksioneve të përkthyer në valuta të tjera përveç Euros përfshihen në fitim ose humbje duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë.

Asetet monetare dhe detyrimet në valuta të tjera përveç EUR janë të përkthyer në Euro sipas kursit mesatar të këmbimit të tregut në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimet në valutë të huaj dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve janë reflektuar në fitim ose humbje si ndryshim i fitimeve dhe humbjeve nga kursi i këmbimit.

### **2.6 Prona, impiantet dhe pajisjet**

Artikujt e aseteve materiale të trupëzuara që nga 1 Janar 2005 deklarohen sipas kostos së vlerësuar minus amortizimin e akumuluar dhe dëmtimi, ndërsa aktivet materiale të trupëzuara të blera pas 1 janarit 2005 deklarohen në kosto minus amortizimin e akumuluar dhe dëmtimin, nëse ka ndonjë.

Kostoja e supozuar paraqet vlerat fillestare të aktiveve të vlerësuara nga Kompania me ndihmën e një konsulenti të pavarur në kohën e konvertimit nga Korporatë në Shoqëri Aksionare më 1 janar 2005.

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të asetit apo njihen si një aset i veçantë, siç është e përshtatshme, vetëm kur është e mundshme që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me artikullin do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e asetit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera i janë ngarkuar në fitim ose humbje gjatë periudhës financiare në të cilën ato kanë ndodhur.



## 2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (Vazhdim)

### 2.6 Prona, impiantet dhe pajisjet (vazhdim)

Toka dhe pyjet mbahen sipas kostos së vlerësuar dhe nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi në asetet e tjera është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të shpërndarë kostot e tyre ose shumat e rivlerësuara të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar, si vijon:

Toka në mihje	6 - 50 vjet
Ndërtesat	10 - 50 vjet
Pajisjet e rënda industriale	10 - 15 vjet
Automjetet	6 - 7 vjet
Mobilitet, montimi dhe pajisjet	5 - 7 vjet

Vlera e mbetur e asetëve dhe jeta e përdorimit janë rishikuar, dhe rregulluar nëse ka qenë e përshtatshme, në secilën datë të pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera bartëse e një asemi është shlyer menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera kontabël e asetit është më e madhe se shumata e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga shitja janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto janë të përfshira në fitim ose humbje.

### 2.7 Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme përbëhen nga softuerët kompjuterik të licencuar. Këto fillimisht deklarohen sipas kostos së tyre dhe më pas sipas kostos minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar të dëmtimeve, nëse ka. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë të gatshme për përdorim duke përdorur metodën lineare sipas së cilës kostoja e asetit të patrupëzjar zvogëlohet gjatë jetës së tij të dobishme..

Kompania ka regjistruar koston e vlerësuar të asetëve, më 1 janar 2005, në bazë të shumës bruto, ku kostoja historike dhe zhvlerësimi deklarohen ndarazi dhe efektet e ndonjë shlyerjeje gjatë periudhave pasqyrohen në përputhje me rrethanat.

### 2.8 Dëmtimi i asetëve jo-financiare

Asetet të cilat nuk kanë jetëgjatësi të përcaktuar nuk janë subjekt i amortizimit dhe testohen për dëmtim çdo vit. Asetet që janë subjekt i amortizimit rishikohen për dëmtim kurdo që ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë se shumata bartëse mund të mos jetë e rikuperueshme. Një humbje nga dëmtimi njihet për shumën me të cilën vlera kontabël e asetit e tejkalon shumën e tij të rikuperueshme. Shumata e rikuperueshme është kostoja më e lartë e vlerës së drejtë të një asemi minus vlera e shitjes dhe vlera në përdorim. Për qëllime të përcaktimit të dëmtimit, asetet grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat identifikohen veçmas flukset e mjeteve monetare (njësitë që gjenerojnë para). Asetet jo-financiare që kanë pësuar dëmtim rishikohen për rikthime të mundshme të dëmtimit në çdo datë raportimi.

### 2.9 Instrumentet financiare

Kompania i klasifikon investimet e veta në këto kategori: asetet financiare të mbajtura në vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, hua dhe të arkëtueshme, investime të mbajtura deri në maturim dhe investime të gatshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi i secilit investim. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e investimeve në njohjen fillestare dhe i rivlerëson në secilën datë raportimi.

## 2.POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (Vazhdim)

### 2.9 Instrumentet financiare (vazhdim)

#### Njohia fillestare dhe çregjistrimi

Blerjet dhe shitjet në mënyrë të rregullt të aseteve financiare njihen në datën e tregtimit - datën në të cilën Kompania angazhohet për të blerë ose shitur asete. Asetet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, në rastin e të gjitha aseteve financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e tyre. Asetet financiare të cilat mbahen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes njihen fillimisht me vlerën e drejtë, dhe kostot e transaksionit kalojnë në fitim ose humbje.

Asetet financiare çregjistrohen kur e drejta për të marrë rrjedhjen e parasë së gatshme prej tyre ka skaduar ose kur ato janë transferuar dhe Kompania gjithashtu ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

#### a) Asetet financiare të mbajtura në vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes

Kjo kategori ka dy nën-kategori: asetet financiare të mbajtura për tregtim dhe ato të përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në fillim. Një aset financiar klasifikohet në "aset financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes" në fillim nëse merret kryesisht për qëllim të shitjes në afat të shkurtër, në qoftë se ajo formon një pjesë të portofolit të aseteve financiare i cili ka dëshmi për fitim-marrjen afatshkurtër, ose në qoftë se kështu është caktuar nga Menaxhmenti. Asetet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes mbahen më pas me vlerën e drejtë. Fitimet e realizuara dhe të parealizuara dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e saktë të 'aseteve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes' janë përfshirë në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato lindin. Kompania nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori.

#### b) Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshme janë asete jo-derivative financiare me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, përveç atyre që Kompania ka ndërmend të shesë në afat të shkurtër apo se ajo ka përcaktuar si me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes apo si të gatshme për shitje. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus provizionet për zhvlerësim. Një provizion për zhvlerësim të huave dhe llogarive të arkëtueshme krijohet kur ka evidencë objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat në përputhje me termat e tyre origjinale.

Të arkëtueshmet tregtare klasifikohen në këtë kategori. Ato njihen fillimisht me vlerën e saktë dhe më pas maten me shumat e rikuperueshme, minus provizionet për zhvlerësim. Një dispozitë për zhvlerësim të llogarive të arkëtueshme tregtare vendoset kur ka evidencë objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme. Vështirësitë e theksuara financiare të debitorit, mundësia që debitori do të falimentojë ose do të riorganizohet financiarisht, dhe mospagesa ose pagesat e vonuara (më shumë se 30 ditë vonesë) konsiderohen si tregues se të arkëtueshmet tregtare janë dëmtuar.

## 2.POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (Vazhdim)

### 2.9 Instrumentet financiare (vazhdim)

Vlera e bartur e aseteve ulet nëpërmjet përdorimit të një llogarie kompensimi, dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një e arkëtueshme tregtare është e pakthyeshme, siç është një shlyerje kundrejt llogarisë së kompensimit për të arkëtueshmet tregtare, arkëtimet pasuese të shumave paraprakisht të shlyera kreditohen në fitim ose humbje.

#### (c) Asetet financiare të mbajtura deri në maturim

Asetet financiare të mbajtura deri në maturim janë asete financiare jo derivate me pagesa fikse apo pagesa të përcaktuara dhe përmbushje të afatit tjetër përveç atyre që plotësojnë përkufizimin e huave dhe llogarive të arkëtueshme që Menaxhmenti i Kompanisë ka një synim pozitiv dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Këto asete njihen fillimisht me vlerën e saktë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus provizionet për zhvlerësim. Një provizion për zhvlerësimin e letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim është krijuar kur ka evidencë objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat në përputhje me kushtet e tyre origjinale.

#### d) Asetet financiare të gatshme për shitje

Asetet financiare të gatshme për shitje janë asete financiare jo derivate që janë përcaktuar në këtë kategori ose nuk janë klasifikuar në asnjë nga kategoritë e tjera. Asetet financiare të gatshme për shitje mbahen me vlerën e drejtë. Fitimet e përcaktuara dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e saktë të letrave me vlerë jo-monetare të klasifikuara si të gatshme për shitje njihen në kapitalin neto. Kur letrat me vlerë të klasifikuara si të gatshme për shitje janë shitur ose zhvlerësohen, rregullimet e akumuluar të vlerës së drejtë janë të përfshira në fitim ose humbje si fitimet / humbjet neto të realizuara mbi asetet financiare. Interesi mbi asetet e gatshme për shitje i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv njihet në fitim ose humbje. Dividendët mbi instrumentat e kapitalit të gatshëm për shitje njihen në fitim ose humbje kur e drejta e Kompanisë për të marrë pagesa vendoset. Të dyja janë të përfshira në llogarinë të ardhurave të investimeve. Kompania nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori.

#### Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e investimeve bazohet në çmimin e saktë të ofertës. Nëse tregu për asetet financiare nuk është aktiv, Kompania kryen vlerësimet e sakta duke përdorur teknikat e vlerësimit. Këto përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të në rrjedhën normale të biznesit, referenca për instrumente të tjera që në thelb janë të njëjta, zbritjen e rrjedhjes së pasasë së gatshme etj.

### 2.10 Stoqet

Materialet, pjesët rezervë dhe të konsumit, kryesisht lidhen me termocentralin dhe minierën, dhe janë vlerësuar me koston më të ulët të dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e bëra në blerjen e stoqeve dhe sjelljen e tyre në vendin e tyre dhe kushtet aktuale. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus shpenzimet e aplikueshme variable të shitjes. Materialet dhe pjesët rezervë shpenzohen apo kapitalizohen në asetin material të përshtatshëm kur instalohen. Një provizion për stoqet me lëvizje të ngadalshme dhe të vjetëruara (përfshijtur qymyrin dhe karburantet) njihet në fitim ose humbje, bazuar në vlerësimin më të mirë të menaxhmentit.



## 2.POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (Vazhdim)

### 2.10 Stoqet (vazhdim)

Linjiti: Kompania nxjerr linjitin e saj i cili është përdorur në procesin e prodhimit për gjenerimin e energjisë elektrike në termocentralet e saj, e cila punon në dy minierat. Rezervat e linjtit janë paraqitur në kosto, e cila përfshin koston direkte të nxjerrjes dhe një pjesë përkatëse të shpenzimeve indirekte që janë shkaktuar me nxjerrjen e tij.

### 2.11 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paratë e gatshme në dorë dhe në banka. Për qëllime të rrjedhës të mjeteve monetare, paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj përfaqësojnë paratë e gatshme dhe depozitat e pakufizuara në banka me periudhë maturimi prej tre muajsh ose më pak.

### 2.12 Huamarrjet

Huatë përfaqësojnë kreditë e marra nga institucionet financiare dhe qeveritare dhe maten në vlerën e tyre të drejtë në kohën e njohjes fillestare, duke qenë vlera e drejtë e shumës së arkëtuar neto e kostove të transaksionit. Pas njohjes fillestare, huamarrjet njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Kostot e huamarrjes që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një asemi të kualifikuar janë të njohur si pjesë e koston së atij asemi. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato kanë ndodhur.

### 2.13 Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Të pagueshmet tregtare dhe të pagueshmet tjera janë matur në kosto e cila është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e pranuar nëse i janë faturuar Kompanisë apo jo.

### 2.14 Kostot për përfitimet me daljen në pension

Kompania nuk bënë asnjë provizion dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve mbi dhe përtej kontributeve të paguara në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

### 2.15 Tatimi

Tatimi është dhënë në pasqyrat financiare në përputhje me rregulloren tatimore të Kosovës në fuqi nga 01 shtatori 2015, Ligji nr 05 / L -029 "Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave". Tatimit mbi të ardhurat i ngarkuar në fitim ose humbje për vitin përfshin tatimin aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë. Tatimi aktual është llogaritur në bazë të fitimit të tatueshëm që pritet për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në fitim ose humbje, sepse ai përjashton artikujt e të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet tjera dhe atë më tej përjashton artikujt që nuk janë të tatueshme ose të zbritshme.. Taksa të tjera përveç tatimit në të ardhura janë regjistruar në kuadër të shpenzimeve operative.

## 2.POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (Vazhdim)

### 2.15 Tatimi (vazhdim)

Tatimi i shtyrë njihet për diferencat midis vlerës kontabël të aseteve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës së taksave korresponduese të përdorura në llogaritjen e fitimit të tatueshëm dhe janë të përfshira në kontabilitet duke përdorur metodën e bilancit. Detyrime tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme dhe aseteve tatimore të shtyra njihen në atë masë që është e mundshme që fitimet e tatueshme do të jetën dispozicion kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme mund të përdoren.

Vlera kontabël e aseteve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe reduktohet deri në masën që nuk është më e mundur që fitimi i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë në dispozicion për të lejuar të gjithë ose një pjesë e asetit të mbulohen

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohen në periudhën kur shlyhet pasivi ose asetit realizuar. Tatimi i shtyrë ngarkohet apo kreditohet në fitim ose humbje, përveç kur ka të bëjë me artikujt regjistruar ose kredituar kapitali si pronë, pajisje apo makineri e rivlerësuar më parë, trajtohet si kosto e supozuar kalimtare në SNRF, në të cilin rast tatimi i shtyrë është trajtuar edhe në ekuitet. Matja e mëpasshme të detyrimit tatimor të shtyrë kontabilizohet edhe në kapital si ardhurë tjetër përmbledhëse.

Tatimet e shtyra për asetet dhe detyrimet janë kompensuar, kur ekziston një e drejtë e ligjshme të zbatueshme të kompensojë asetet tatimore aktuale kundrejt detyrimeve tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me tatimet mbi të ardhurat vëna nga autoriteti tatimor dhe të njëjtën Kompania synon për të zgjidhur aktivet aktuale tatimore dhe detyrimet e veta në një baza neto..

### 2.16 Njohja e të hyrave

Të hyrat nga shitja e energjisë elektrike janë të njohura kur energjia elektrike ofrohet për konsumatorët. Faturimi për shitje të energjisë elektrike bëhet çdo muaj brenda pesë (5) ditëve të muajit që pason muajin në të cilin konsumi i energjisë elektrike është kryer.

### 2.17 Grantet Qeveritare

Grantet qeveritare nuk njihen derisa të ekzistojë një siguri e arsyeshme që Kompania do të respektojë kushtet që shoqërojnë ato dhe se grantet do të pranohen.

Grantet qeveritare, kushti kryesor i të cilave është që Kompania duhet të blejë, ndërtojë ose përndryshe fitojnë aktivet afatgjatë njihen si të ardhura të shtyra në pasqyrën e pozicionit financiar dhe të transferohet në fitim ose humbje mbi një bazë sistematike dhe racionale jetëgjatësisë së dobishmërisë së aktiveve.

Përveç kësaj kompania merr grante qeveritare për blerjen e energjisë elektrike kur është e nevojshme. Kompania shtyn grante të tilla derisa energjia elektrike e blerë dorëzohet dhe faturohet te abonentët, që përgjithësisht ndodh brenda vitit.

### 2.18 Provizionet

Një provizion njihet kur Kompania ka një obligim aktual si rezultat i një ngjarje të kaluar dhe është e mundur që një dalje e burimeve të materializuar në përfitimet ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet pjesë e shumës së detyrimit. Provizionet rishikohen në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe rregullohen për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual. Aty ku efekti i vlerës në kohë të parash është material, shuma e provizionit është vlera aktuale e shpenzimeve të pritura për të shlyer detyrimin.

## 2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (Vazhdim)

### 2.19 Palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura janë ato ku njëra nga palëeshtë e kontrolluar nga tjetra, ose ka ndikim të rëndësishëm në marrjen e vendimeve financiare apo të biznesit të palës tjetër.

### 2.20 Zotimet dhe kontigjentët

Detyrimet kontingjente nuk janë të njohura në pasqyrat financiare. Një detyrim kontingjent është shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhjes së parasë që materializon përfitime ekonomike është e dobët. Një aktiv kontingjent nuk është i njohur në pasqyrat financiare por shpaloset kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjes kontingjente njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do të konfirmojnë se, një detyrim i pësuar në datën e pasqyrës së pozicionit financiar dhe një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes së rezultuar mund të bëhet.

### 2.21 Ngjarjet pas datës raportuese

Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat japin informacione shtesë për pozitën e kompanisë në pasqyrën e pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) janë të prezantura në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat nuk janë të rregulluara janë diskutuar në shënime kur ato ngjarje janë materiale.

## 3 GJYKIMET KRITIKE NË APLIKIMIN E POLITIKAVE TË KONTABILITETIT TË KOMPANISË

Nuk ka gjykime kritike, përveç atyre që përfshijnë vlerësimet (Shih 3.1 më poshtë), që menaxhmenti ka bërë në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit të Shoqërisë dhe që kanë ndikim të rëndësishëm në shumën e prezantuar në këto pasqyra financiare.

### 3.1 Burimet kryesore për vlerësimin e pasigurisë

Në vijim janë supozimet kyçe lidhur me të ardhmen, dhe burime të tjera kryesore të pasigurisë në vlerësim në fund të periudhës së raportimit, që kanë një rrezik të rëndësishëm të shkaktuar një rregullim material në kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar.

#### *Zhvlerësimi dhe jetëgjatësia funksionale e aktiveve afatgjata të trupëzuara*

Siç përshkruhet në shënimin 2.6 më sipër, Kompania rishikon jetën e dobishme të aktiveve afatgjata të trupëzuara në fund të çdo periudhe raportuese. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave apo faktorëve tjerë mund të ndikojnë jetët e dobishme të aktiveve dhe në përputhje me rrethanat mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme vlerën kontabël neto të këtyre aktiveve.

Vlera aktuale e aktiveve afatgjata të trupëzuara varet nga vendimet e rregullatorit të pavarur të energjisë së Kosovës për përcaktimin e tarifave të energjisë. Ndryshimet në të ardhmen të nivelit të tarifave mund të ketë ndikim të dukshëm në vlerën aktuale të aktiveve të Shoqërisë.

#### *Provizionimi i të arkëtueshmeve dhe stoqeve*

Në rrjedhën normale të biznesit, kompania bën vlerësimin për arkëtimin dhe realizimin e të arkëtueshmeve dhe stoqeve respektivisht. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti shënon një provizionim të përshtatshëm të llogarive të arkëtueshme dhe të uljes së stoqeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet.

### 3 GJYKIMET KRITIKE NË APLIKIMIN E POLITIKAVE TË KONTABILITETIT TË KOMPANISË (Vazhdim)

#### *Vlerësimi i rasteve ligjore:*

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësim për shumat e zgjidhjes së çështjeve ligjore siç tregohet nga mbrojtësi ligjor i kompanisë. Në bazë të këtij vlerësimi, kompania në përputhje me rrethanat regjistron provizionimin nëse ka ndonjë, ose të bënë të ditur shlyerjen e stoqeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet.

#### *Vlerësimi për mjedisin, dekomisionimin dhe çështjet e tjera të ngjashme*

Aktualisht nuk ka asnjë kërkesë detyruese ligjore për mjedisin, dekomisionimin dhe dispozitat e tjera të ngjashme në Kosovë. Kompania rregullisht kryen vlerësimet e saj të brendshme për provizione të tilla dhe i njeh ato në varësi të natyrës dhe rrethanave përreth këtyre dispozitave. Në varësi të natyrës dhe madhësisë së operacioneve të Kompanisë në të ardhmen dhe në ndonjë ndryshim të mundshëm në kornizën ligjore në Kosovë, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet e Kompanisë.

### 4. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHPALOSJET

#### **Adoptimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara të Raportimit Financiar Ndërkombëtarë**

#### **Standardet e reja dhe amandamentet të miratuara nga ana e kompanisë**

Përmirësimet në SNRF-të 2017 kane bere disa ndryshime të vogla në një numër të SNRF-ve. Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese dhe interpretimeve nuk ka çuar në ndonjë ndryshim në politikat kontabël të kompanisë.

**Ndryshimet në SNRF-të të cilat janë të detyrueshme për tu aplikuar për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017.**

